



FKPKK

Federata Kombëtare e
Pyjeve dhe Kullotave
Komunale, Shqipëri

www.shkpkk.org



APPK

Asosacioni i
Pronarëve të Pyjeve
Privatë, Kosovë

www.akppp.org

Kurora e Gjelbër

Gazetë Periodike, Tiranë (Viti i katërbëdhjetë i botimit) Nr. 119, gusht 2012 Çmimi 20 lekë

Privatizimi i pyjeve të mbështetet me ligj

Pronësia private mbi tokën bujqësore, pemët frutore, ullishtat, pyjet, kullotat e livadhet, ka qenë njohur në Shqipëri që në fillim të viteve 1900. Po ashtu, ka ekzistuar prona e përbashkët e fshatit apo fisit. Ka pasur ligje e zakone të rrepta për ruajtjen e pronës, të cilat zbatoheshin nga shoqëria e atëhershme si ligj i pashkruar. Në veçanti, "Kanuni i maleve" dhe "Ligja e pyjeve dhe kullosave" e vitit

1923, përmbanin dënime të rënda për shkeljen e ligjeve të pronësisë.

Gjatë periudhës së tranzicionit, objektivi kryesor i politikës pyjore, përta i përket zhvillimit të pylltarisë private, ka qenë rikthimi i pyjeve private sipas pronësisë së vitit 1945. Njohja e pronësisë dhe rikthimi i pronave të marra gjatë viteve 1945-1990, është përcaktuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar më 21 tetor

1998 (nenet 41 e 181). Neni 181 përcakton objektivin e parlamentit për të amenduar e plotësuar brenda 2-3 vjetëve kuadrin ligjor lidhur me çështjet e zënies apo konfiskimit të tokave, të bëra para miratimit të Kushtetutës. Strategjitë e DPPK për Zhvillimin e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave në Shqipëri (1999-2004) e kanë pranuar "Njohjen e të drejtave të pronësisë private dhe privatizimin e pronës publike" (fq. 45).

Bëmë këtë përshkrim të shkurtër historik, për të dalë në përfundimin se, sipas Kushtetutës, ekziston mundësia për privatizimin e pronës publike.

Sipas të dhënave të publikuara nga komunat-pilot **Malzi e Bujan (Kukës), Melan, Maqellarë, Zerqan e Ulëz (Dibër), Blerim (Pukë), Kurvelesh (Tepelehtë), Markat (Sarandë), Grekan, Tregan e Papër (Elbasan)** del se mbi 30 %

Rexhep NDREU
Kryetar i FKPKK, Tiranë



e banorëve njihen pronarë tradicionalë të pyjeve e kullotave dhe fshati i njeh e i ka konfirmuar të tillë. Kjo është bërë e njohur edhe në shumë plane menaxhimi nga Projekti i parë i BB për mëse 130 komuna, të APFDP e PZHBN, në 240 plane mbarështimi.

Vijon në fq. 2

Pyjet dhe Uji, kjo lidhje shekullore ...

Albora KACANI

Cilësia dhe disponueshmëria e ujërave në shumë vende të botës janë çdo ditë e më shumë të rrezikuara nga mbipërdorimi,

keqpërdorimi dhe mbipopullimi. Është gjithnjë e më e njohur fakti se të dyja këto janë të ndikuara shumë nga pyjet. Për më tepër, ndryshimet klimatike po ndry-

shojnë rolin e pyllit në rregullimin e rrjedhjeve ujore dhe ndikojnë në disponueshmërinë e burimeve ujore (Bergkamp, Orlando and Burton, 2003). Prandaj, marrëdhënia midis pyjeve dhe ujit është një çështje që kërkon vëmendje.

Meqë në vendin tonë burimet ujore janë burimi kryesor i furnizimit me energji elektrike, e shoh të nevojshëm studimin e ndërveprimeve midis këtyre burimeve ujore dhe burimeve pyjore rreth tyre. Kjo për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndërtimin e kapaciteteve në hidrologjinë pyjore, si dhe për "futjen" e këtyre njohurive në kërkimet shkencore dhe politikat.

Vijon në fq. 3



PREXAlbania projekt inovativ në Shqipërinë dixhitale

Dhurata THANASI, Menaxhere Biznesi pranë ALCDF

Punë e pavarur, projekte afatshkurtër dhe punë e kontraktuar me bollëk në internet, sidomos për IT profesionistë, projektuesit grafikë, kontabilistët, gazetarët, fotografët, etj. Interneti tashmë ka nxitur një treg të lulëzuar të punës për punonjësit e pavarur apo "freelancers", shumë prej të cilëve e sigurojnë punën dhe ofrojnë atë vetëm në mënyrë virtuale. Kjo dukuri që po nxit "the new economy", ka krijuar tashmë tregje miliarda dollare në mbarë botën dhe po nxjerr si imperativ kërkesën në rritje për aftësitë e agentëve të lirë, Guru-ve teknikë dhe profesionistëve të pavarur. Shumë



njerëz tashmë duan të punojnë nga shtëpia dhe mijëra faqe

Vijon në fq. 3

Shkolla Teknike Pyjore, vlerat dhe rëndësia e saj

Inxh. Zhuljeta FRESKU

Faqe 4

Lashtësi, kulturë, pyje e peizazhe të mrekullueshme

nga Faruk BOJAXHI - Inxhinier pyjesh, Prizren

Faqe 5

Një studim bujqësor, hidroteknik në rajonin Gjakovë - Pejë - Istog

Prof.As. Dr. Ahmet OSJA

Faqe 5

Mali i Dajtit, "ballkoni" nga mund të vështrosh Tiranën

GJON FIERZA - Inxh. në DSHP, Tiranë

Faqe 7

TRAJTIMI I VERRISHTEVE E SHELGISHTEVE, ME INTERES PËR FERMERIN

nga ILMIGJANA

Faqe 6

Privatizimi i pyjeve të mbështetet me ligj

Vijon nga fq. 1

Këto fakte janë një bazë e mirë për t'i argumentuar Qeverisë se bazuar në traditën, si dhe në Kushtetutë, privatizimi është i mundur dhe, mbi këtë bazë, në ligjin e ri të Pyjeve, që po hartohet, të vendoset pronësia private dhe njohja me ligj e pronarëve tradicionalë që njeh fshati.

Në 10 vite asnjë zjarr në pyjet e fermerëve, që s'i njeh Ministria?

Vetëm në pyjet e fermerëve, që njihen tradicionalisht përdorues, 10 vitet e fundit s'ka patur asnjë zjarr apo dëmtime të tjera, s'ka pasur prerje rrah dhe as erozion.

Dhjetë vitet e fundit rreth 200 mijë ha pyje dushku krejtësisht të degraduara në rajonet Librazhd, Lugina e Drinit, Shkodër, Malësi e Madhe, Kukës, Has, Tropojë, Lugina e Matit, Burrel, Bulqizë, Dibër, etj., si rrjedhojë e kujdesimeve nga pronarët tradicionalë dhe me mbështetjen e Shoqatave e Federatave, pyjet kanë arritur të sigurojnë një rritje vjetore 2-3 herë më të madhe se pyjet shtetërore ose kolektive. Kjo është e dokumentuar me rreth 200 sipërfaqe prove të përhershme, të cilat monitorohen çdo dy vjet dhe është një mësim për fermerin dhe pylltarët në terren. **(I ftojme të gjithë t'i shikojnë në terren).**

Ekspertët e pyjeve, por edhe drejtuesit dhe institucionet nuk e njohën kurrë **sistemin e zabelit**, për të cilin punohet pothuaj nga pjesa më e madhe e fermerëve në pyjet e vegjël rreth shtëpive, si një potencial i madh, që bën të mundur të sigurojnë dru, gjeth e shkarpa dhe ndihmon të shpëtojnë pyjet e lartë të ahut e pishës.

Kjo për Ne është ai 30 %, që flasim për privatizim, që shpëton jo vetëm pyjet e lartë, por integron fermën dhe legalizon përdoruesit, siguron përdorim të mirë dhe rrit përgjegjësinë e njerëzve për tokën e pyllin, si dhe përmirëson jetesën e tyre. DPK dhe FSHP, duhet të zbresin më shumë në terren, të njohin dhe mësojnë realitetin, për vete, po t'ua mësojnë këtë realitet shekullor edhe ekspertëve e studentëve për

mënyrat e menaxhimit të pyjeve nga fermerët në Shqipëri.

Vlen të theksohet gjithashtu se popullsia rurale përbën rreth 43 % të popullsisë së përgjithshme dhe 71 % e popullsisë rurale është e punësuar në aktivitete bujqësore, përfshirë pyjet. Sipas nesh, duhet të vazhdoje procesi i transferimit, në bazë të Ligjit nr. 8743 dt. 22.02.2001 dhe të dërgohen në çdo Njësi të Qeverisjes Vendore inventaret e pronave, me dokumentacionin përkatës, si kadastra me gjendjen ekzistuese dhe harta e pyjeve dhe kullotave të dixhitalizuara dhe vektoriale. Ministria të bëjë regjistrimin e të gjitha pronave, pyje e kullota, në zyrat e regjistrimit PP, duke bërë analizën e nevojave dhe mundësive dhe të behet transferimi i pyjeve e kullotave sipas përcaktimeve nga Këshilli i Ministrave me Vendim për çdo NjQV. Pra, në bazë të këtij Ligji, kur bëhet transferimi i pronave, shoqërohet me **detyrimet përkatëse financiare të NjQV** dhe asaj qendrore për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e pronës, gjë që nuk është bërë deri sot edhe pse është kërkuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore.

I nënvizuam këto, pasi transferimi i bërë me vendim nuk u shoqërua me masa konkrete dhe me akte e udhëzime për mënyrën e regjistrimit të këtyre pronave. Për pasojë, edhe pse kane kaluar 3 vjet, shumë Komuna nuk kanë reregjistruar pronat, madje as vetë Shteti nuk bën regjistrimin në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Kjo është jashtëzakonisht e dëmshme, sepse kurrkush nuk di sa prona ka dhe ç'duhet të bëjë me to.

Duke qenë "magazinë pa çelës" të gjithë luajnë me shifra, pa përgjegjësi priten dy milionë m³ në vit e shiten 200 mijë m³ dhe mbahet një qëndrim sikur s'ka ndodhur asgjë, edhe pse masive të tëra pyjesh priten me urdhra e pa kriter, digjen dhe asnjë nuk di sa digjen e sa priten.

Aktualisht komuna ka në dorë një vendim të qeverisë për pyllin, po asgjë tjetër. Ky boshllëk, si ligjor edhe institucional, mund të "kontribuojë" në dëm të pyllit të brishtë, që mezi po tenton të marrë veten vitet e fundit. Ajo nuk janë njohur kufijtë e pyjeve midis fshatrave, komunave e midis rretheve.



Përdoruesit nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojnë të drejtat e tyre të përdorimit apo pronësisë mbi pasuritë e trashëguara nga nderit e TYRE.

Pyjet nuk privatizohen pa ligj!

Bazuar në ligjet ekzistuese dhe vendimet e Qeverisë, nuk mund të privatizohen pasuritë publike, prandaj dhe kërkesa e Qeverisë është që të **gjenden mekanizmat për privatizimin**. Nisur nga kjo, mendojmë që mekanizmi është: **"Të njihen ligjërisht pronarët tradicionalë, që i njeh edhe vetë fshati"**. Pra, është e nevojshme që në Ligjin e Ri të vendoset kjo kërkesë e Qeverisë dhe e **përdoruesve tradicionalë në Shqipëri**, me qëllim që të sjellim një garanci të re për qëndrueshmëri të menaxhimit të pyjeve për herë të parë, por dhe duke korrigjuar padrejtësitë historike për pronarët, që në fakt kanë qenë dhe janë të shumtë.

(Ashtu siç komisioni i fshatit ka vendosur për ndarjen e tokës bujqësore, të vendosë edhe për ndarjen e tokës pyjore sipas përdoruesve tradicionalë të njohur prej tyre).

Janë shumë pak njerëz, jashtë atyre në konflikt të

plotë interesi, që kanë kundërshtime në procesin e privatizimit, krahasimisht me shumicën e njerëzve dhe strukturave nga të gjitha nivelet.

Le të shpresojmë se së bashku me përvojën e krijuar, të mbështesim sektorin për një reformë të thellë drejt transferimit, privatizimit dhe regjistrimit të pyjeve privatë, komunalë e shtetërore. Kjo, mendojmë, është alternativa më e efektshme për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, si objektivi madhor në kushtet e ndryshimeve klimatike për Shqipërinë e më gjerë.

A duhet të jepen pyjet me koncesion në Shqipëri?

Bazuar në vëzhgimet aktuale, vendi ynë po përballet me humbje të dukshme të kapitalit pyjor. Të dhënat, nga shumë burime, transmetojnë në vazhdimësi të njëjtin mesazh. Nga analizat duhet të besojmë që pylli shqiptar në gjendjen aktuale nuk ka kapacitet të plotësojë nevojat e zonave rurale për dru zjarri e lëndë ndërtimi. Kullotat e Jugut nuk i plotësojnë nevojat e blegtorisë për kullotje. Këta tregues jepen me alarme, jo

vetëm nga studiuesit në planet e menaxhimit, por i thonë njerëzit çdo ditë.

Ashtu siç është deklaruar, rreth 50 % e pyjeve, apo fondit pyjor, tashme janë transferuar në pronësi të 317 NjQV dhe ky proces vazhdon sipas një urdhri të veçantë të Ministrit të Mjedisit me **Nr. 4086, dt. 13.07.2011** dhe objektivave të Qeverisë për transferimin dhe privatizimin. Ne mendojmë se janë komunat/qarqet, përdoruesit tradicionalë, ata që duhet të vendosin se si do t'i shfrytëzojnë pyjet e tyre, nëpërmjet vetë shoqatave/kompanive të shfrytëzimit e jo të vendoset nga lart, nga DPK apo DSHP, që pyjet të shfrytëzohen me koncesion, kur pyjet janë në pronësi të komunave dhe prishmëria e Qeverisë është që të thellohet më tej privatizimi.

Objektivi i Qeverisë dhe i MMPAU është që të rritet sipërfaqja dhe numri i zonave të mbrojtura. Përveç kategorive të Zonave të Mbrojtura sipas klasifikimit të IUCN-se, MMPAU ka shpallur me VKM edhe një pjesë të pyjeve si rezerva strategjike, që mund të përdoren vetëm në raste fatkeqësish natyrore.

Argumentet që sollëm, si dhe gjendja reale e pyjeve në Shqipëri e bën të pamundur idenë për të zhvilluar koncesionin në pyje. Madje, ekspertët ndërkombëtarë (misioni i BB) shtojnë se edhe bazuar në eksperiencat e vendeve të tjera, si ish-Republikat Sovjetike, del se koncesioni nuk është formë e mirë edhe për ato vende, që janë më të pasura me rezerva pyjore.

Njoftim për shtyp

Vërtetohet prania e rrëqebullit të Ballkanit në Parkun Kombëtar të Shebenik-Jabllanicës

Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) ka kënaqësinë të njoftojë se më 7 gusht 2012 u fotografua rrëqebulli i parë ballkanik në zonën e Parkut të Shebenikut. Kjo foto shënon kulmin e një periudhe disa vjeçare të monitorimit të jetës së egër nga PPNEA në territorin e këtij Parku Kombëtar. Sipas kërkuesve të PPNEA, Aleksandër Trajçe e Bledi Hoxha, në zonën e Shebenikut janë kryer dy sesione intensive monitorimi gjatë viteve 2009 dhe 2011, të cilat nuk mundën të provonin ekzistencën e rrëqebullit. Ndërkohë që gjatë vitit 2012 u kryen monitorime sporadike, të cilat,



edhe pse të kufizuara në hapësirë e kohë, rezultuan të suksesshme.

Shpallja e Shebenikut zonë e mbrojtur në vitin 2008 u bë pikërisht për vlerat e rajonit si habitat i rëndësishëm për gjitarët e mëdhenj dhe në veçanti në lidhje me mundësinë e pranisë së rrëqebullit të Ballkanit. Zbulimi i provës së parë të ekzistencës së rrëqebullit

brenda kufijve të Parkut ngjall shpresa se në të ardhmen kjo popullatë do të jetë më e mbrojtur, duke u shndërruar në simbol të trashëgimisë natyrore të zonës. PPNEA bën thirrje për veprime të koordinuara e sinergjike ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit për menaxhimin dhe ruajtjen e Parkut, në mënyrë që të jemi optimistë se rrëqebulli do të vazhdojë të endet i lirë në pyjet shqiptare dhe do të jetë burim frymëzimi e krenarie edhe për brezat e ardhshëm. Nëse dëshironi hollësi të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me PPNEA, në adresën: Rr. "Vangjush Furxhi", P. 16/1/10 Tiranë, Shqipëri contact@ppnea.org

Vijon nga fq. 1

interneti në botë, që ofrojnë punë freelance, kujdesen për të kontraktuar apo mundësuar këtë lloj shërbimi. Ndërsa ekonomitë globale vazhdojnë të luftojnë me krijimin e vendeve të punës, puna online gjatë vitit 2011 lulëzoi me 650.000 vende të reja të postuara në faqet e internetit më të specializuara në botë, me fitim të akumuluar, që i kaloi 500 milionë dollarë. Një nga portalet më të fuqishëm në botë, Elance, arriti të ketë rritje të bizneseve të punësimit dhe numrin e profesionistëve në internet me më shumë se 120 %.

Një mjet i tillë ndërlidhjeve vjen nëpërmjet PREXAlbania, i pari portal që mundëson ndërlidhjen virtuale të ekspertëve me kërkesën për shërbime të çdo lloji fushe e kategorie. Në këtë portal çdokush do mund të konkurrojë, kërkojë apo ofrojë online shërbimet e duhura, ndarë mbi bazë profesionale e kategorish, apo të postojë projekte e tendera. I krijuar nga ALCDF, Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale, PREXAlbania që në fillim ka shërbyer si vendtakimi virtual për procedurat e tenderimit dhe menaxhimit të granteve të këtij Fondacioni. Specialistë, inxhinierë, ekonomistë, punonjës të zhvillimit të turizmit, pylltarisë, bujqësisë, OJF-ve apo organe të qeverisjes lokale, duke u anëtarësuar falas në PREXAlbania, mundën që në kohë reale të vëzhgojnë çdo hap të procedurave të tenderimit apo zhvillimit të projekteve, duke marrë pjesë virtualisht në një proces krejtësisht transparent.

Por, më saktë, si funksionon PREXAlbania? Ç'të mirë të përbashkët do të kenë një

PREXAlbania projekt inovativ në Shqipërinë dixhitale

inxhinier pyjesh, që punon në Shushicë të Elbasanit, një i ri, që rishtas po diplomohet në Administrim Biznesi në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", kryetari i Qarkut të Elbasanit, të cilit i nevojitet një plan i zhvillimit strategjik të Qarkut, apo një vajze të re që sapo është bërë nënë për të parën herë? PREXAlbania është një alternative e zgjidhjes së problemeve të këtyre njerëzve. Duke u regjistruar fare thjesht dhe futur të dhënat e nevojshme, do të bëhet i mundur krijimi i një profili profesional. Sa më i saktë e i plotë të jetë ky profil profesional, aq më i/e marketueshëm apo i "shitshëm" do të jetë në treg individit, kompania apo çdo lloj subjekti i regjistruar. Shumëkush do mund të zgjedhë fushën apo profesionin e dëshiruar, kategoritë dhe nënkategoritë e shumta ku mendon se mund të ofrojë apo kërkojë shërbime, informacion apo ekspertizë. Bazuar në këto të dhëna, çdo i regjistruar në portal do bëjë të mundur krijimin e faqes apo profilit të tij dhe krejt në mënyrë të pavarur t'i lançojë ofertën e tij çdo lloj shërbimi.

Inxhinieri i pyjeve në Shushicë apo Krastë do mund t'u ofrojë 20 komunave ekspertizën e tij për planet e menaxhimit të Pyjeve në Qarkut të Elbasanit, studenti i sapo-diplomuar të kërkojë të kryejë stazhin në 10 kompanitë më të mira të Shqipërisë, që kërkojnë

praktikantë për studime tregu biznesi, kryetarit të Qarkut të Elbasanit të përzgjedhë online strategjistët më të mirë në hartimin e Planeve të Zhvillimit, si dhe nënës së re mundësinë për të vazhduar karrierën, duke rritur njëkohësisht foshnjën e saj.

Vetëm brenda një viti PREXAlbania mundi që në qarkun e Elbasanit dhe, jo vetëm, të regjistrojë shumë ofrues shërbimesh të këtij rajoni me potencial të konsiderueshëm për zhvillim kapacitetesh. Ky lloj shkëmbimi virtual ka krijuar jo vetëm mundësinë e një transparence në proces, por dhe ka mundësuar aksesimin e shërbimeve në skajet më të largëta të vendit tonë, duke nxitur kërkesën për shtimin e teknologjive të informacionit dhe aty ku më parë nuk ishin, si dhe u ka dhënë shansin e barabartë në pjesëmarrje projektesh apo punësh të ndryshme edhe atyre specialisteve apo zanatçinjve që deri dje, për arsye të ndryshme, mund të ishin lënë jashtë projekteve, mundësive apo nismave nga shumë kolegë të tyre kryeqytetas.

Në një botë çdo ditë e më shumë dixhitale, PREXAlbania vjen si mundësi inovatore, efiçente në duart e kujtdo që është në kërkim të një ardhmeje të begatë.

Mos harro të shkruash - PREXAlbania.com dhe puna është një klik larg teje!



"Dushku (Lisi) i Lleshanit" në Gjinar të Elbasanit, i shpallur "Monument Natyre, ruhet e vlerësohet nga vendasit si dru i shenjtë:

- Mosha - mbi 700 vjeçare.
- Lartësia - 25 m.
- Trashësia e trungut mbi 3 m.
- Kurora me diametër 30 m.

Sa bukur, po të ketë ndodhur kështu!

Vetë mjedisi e diktonte që pellazgu i parë të ngjizej (simbolikisht) në brendinë e një shpendi të fisshëm, siç është Shqiponja.

Për ta rritur e mori përsipër dhia, e cila jetonte ngjitur atyre majave, ku vetë shqiponja kishte follenë. Më pas u bë i nevojshëm edukimi dhe kjo "iu la në dore" Lisit. Këtu, në Dodonën e Epirit, dukej sikur vetë natyra ishte kujdesur për këtë bimë me pamje të veçantë. Në atë vend të shenjtë, siç luteshin dhe prisnin përgjigje për enigmat e kohës së tyre apo të fshehtat e së ardhmes. Orakujt shpjegonin gjuhën simbolike të fëshfëritjes së gjetheve.

E, kështu u vazhdua brez pas brezi, deri kur fatosi i shqiptarëve, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, mori përsipër fatet e vendit të tij. Ai, megjithëse u vendos në Krujë, simbolet i mori nga lashtësia.

Kështu, në flamur si simbol vendosi shqiponjën, nga besohej se kanë rrjedhur paraardhësit, në kokë, si diademë, vendosi përkrenaren me kokën e dhisë dhe pelerinën e zbukuroi me gjethet – simbol të lisit, duke e quajtur veten: mbreti i Epirit.



Ahmet OSJA

Pyjet dhe Uji, kjo lidhje shekullore ...

Vijon nga fq. 1

Pyjet, përveç prodhimit të lëndës drusore, u ofrojnë e u sigurojnë njerëzve edhe shërbime të tilla si, mbrojtja e tokës nga erozioni, përmirësimin e cilësisë së ujit, fiksimit e karbonit, rekreacionin, produkte të tjera pyjore dhe biodiversitetin. Por, edhe pyjet, nga ana e tyre, janë përdorues shumë i madh i ujit, pasi kurorat e pemëve, nëpërmjet kapjes së ujit të shiut dhe avullimit mund t'i reduktojnë këto ujëra dhe ndihmon në zvogëlimin e erozionit dhe në mundësitë e përmbytjeve, por redukton edhe ujërat nëntokësore. Përveç të tjerave, pyjet pranë ujëmbledhësve, siç është ai i Bovillës në Tiranë, mbrojnë nga ndotja furnizimet me ujë të pijshëm.



Në ruajtjen e cilësisë së lartë të ujit, pyjet japin kontributin më të madh për karakteristikat hidrojogjike të ekosistemeve të pellgjeve ujëmbledhës. Kjo arrihet nëpërmjet minimizimit të erozionit të tokës në vend, reduktimit të rendimenteve në trupat ujore (ligatinat, pellgjet, liqenet, përrenjtë, lumenjtë) dhe kapjen apo filtrimin e ndotësve të tjerë ujorë në mbeturinat e pyllit.



Në shumë vende, politikat pyjore dhe ujore, planet dhe programet po vijnë së bashku përmes popullaritetit në rritje të skemave të pagesës për shërbimet mjedisore (gjithashtu, i quajtur marrëveshjet nxitëse bashkëpunuese, pagesat e administrimit, skemat e kompensimit ose pagesat e performances) si mekanizma financimi për menaxhimin e pellgut, menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe procese të tjera zhvillimi të qëndrueshëm. Pagesat nuk përfshijnë domosdoshmërisht para; shpesh ato marrin formën e shërbimeve që komunitetit i kanë munguar, si psh rrugë të reja apo më të mira, autobus shkolle ose transport javor për prodhimet bujqësore.

Për shembull, qeveria e Kosta Rikës, që nga viti 1996 ka sponsorizuar skema për të krijuar nxitës (stimuj) ekonomikë për ruajtjen e pyjeve dhe kompensimin e atyre, toka e të cilëve ose përdorimet e tokës, gjenerojnë shërbime mjedisore.

Pyjet duhet të menaxhohen në mënyrë më të mirë për një furnizim të qëndrueshëm me ujë. Prandaj është e nevojshme gjetja e skemave dhe programeve nxitëse të financimit, si dhe gjetja e një ekuilibri midis zhvillimit socio-ekonomik dhe ruajtjes së mjedisit. Zgjidhje të reja teknike për të ekuilibruar përdorimin e shumë shërbimeve të siguruara nga pylli dhe të nevojshme nga shoqëria – përfshirë edhe ato të lidhura me ujin – kanë nevojë të zhvillohen e promovohen te politikëbërësit, duke mundësuar vendime të informuara në lidhje me integrimin e menaxhimit të pyjeve dhe ujërave në një epokë të ndryshimeve globale.

Ref: <http://www.fao.org/docrep/010/a1598e/a1598e02.htm>

Shkolla Teknike Pyjore, vlerat dhe rëndësia e saj

Inxh. Zhuljeta FRESKU



E nderuara Redaksi e Kurorës së Gjelbër, Iniciativa juaj për t'i lënë hapësirë në çdo numër gazete, kontributit të femrave në fushën e pyjeve, më nxiti që edhe unë të shkruaj disa rreshta. Sigurisht, do të përqendrohem në Shkollën e Mesme Teknike Pyjore "Kolë Margjini", Shkodër, pjesë e së cilës

unë jam, sëbashku me një grup inxhinierësh e inxhinieresh, që kontribuojnë në rritjen e dashurisë për pyllin, mirëmbajtjen dhe pasurimin e tij, si dhe në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra. Mendoj se ky shkrim do shërbejë për të dhënë informacion mbi vlerat dhe rëndësinë e studimit në këtë shkollë.

Është shkolla që për gjysmë shekulli ka kontribuar shumë në nxjerrjen e teknikëve dhe inxhinierëve të pyjeve e të përpunim drurit në të gjithë vendin. Është shkolla, që më shumë se kushdo, ka kontribuar në rritjen e sipërfaqes së gjelbër të zonës së Shkodrës, mbi he nën Shkodrës dhe me punën e stafit të saj e të nxënësve, shpesh është bërë pjesëmarrëse në iniciativë të mbrojtjes së pyjeve dhe të shërbimit ndaj tyre, duke marrë pjesë në projekte në shërbim të asaj që ne kemi për zemër "Dashurisë ndaj PYLLIT".

Shkolla pyjore, për ata që nuk e dinë, ndodhet në qendër të qytetit të Shkodrës prej më shumë se një gjysmë shekulli. Ka kontribuar për vite të tëra duke nxjerrë nga bankat e saj një numër shu-

më të madh teknikë pyjesh, të cilët kanë shërbyer në të gjitha zonat e vendit, por edhe kanë mbushur auditorët e Fakultetit të Pyjeve. Gjatë 53 vjetëve të jetës nga bankat e saj kanë dalë rreth 5600 nxënës, pjesa me e madhe e të cilëve sot punojnë në Shërbimin Pyjor Shqiptar, por edhe në bizneset e tyre private, që nga Konispoli deri në Vermosh. Vlen të theksohet se nga ky numër nxënësish janë 110 vajza, që kanë mbaruar profilin pyje.

Ndër vite, shkolla ka pësuar ndryshime në strukturë dhe në përmbajtje, në varësi të kushteve dhe të sistemit arsimor shqiptar e të ndryshimeve që ka pësuar vendi në përgjithësi, duke i dhënë më shumë hapësirë përgatitjes teorike, shkencore dhe asaj profesionale, me synimin

aftësimin e nxënësve për t'i shërbyer tregut të punës. Shkolla Pyjore, me staf pedagogjik të kualifikuar, diti të përballet me kërkesat në rritje të kohës, por edhe t'i bëjë për vete e t'i zgjidhë ato, duke arritur të formojë një brez teknikësh pyjorë dhe të përpunim drurit, të aftë për të marrë detyra të reja, në kushtet e ekonomisë së tregut.

Shkolla Teknike Pyjore "Kolë Margjini" është shkolla e vetme e këtij lloji në Shqipëri dhe ka një strukturë mësimore në përshtatje me kërkesat e kohës. Ajo është e profilizuar në dy drejtime: Pyje dhe



Përpunim druri. Profili Pyje ka degët: 1) Silvikulturë, 2) Shfrytëzim Pyjor, 3) Florikulturë dhe 4) Mbrojtje mjedisi. Ndërsa Profili Përpunim druri ka degët: 1) Mobilieri- Tapiceri, 2) Prodhime gjysmë të gatshme dhe 3) Prodhime artistike druri.

Trajnimet në 50 % të rasteve të stafit pedagogjik të

Shkollës, të kryera në shkollat perëndimore analoge, veçanërisht Itali, Gjermani, Greqi e Danimarkë, por edhe brenda vendit, hapën horizonte të reja, bënë të mundur që mësuesit të përthithin shumë nga metodat më të avancuara të mësimdhënies, duke i harmonizuar ato me programet dhe tekstet dhe aplikimin e tyre në të gjithë procesin edukativ.

Por, pa harruar pjesëmarrjen e vazhdueshme të mësuesve të shkollës në projekte të ndryshme, të GTZ-së, CARDSI-it, Bankës Botërore dhe së fundi VIS Albania, krijuan mundësinë e ngritjes në një

simin e mesëm të përgjithshëm edhe atë profesional, e ka vënë edhe stafin pedagogjik të shkollës pyjore para detyrash të rëndësishme për zbatimin e përgatitjes së qytetarëve të denjë të Evropës së Bashkuar. Ky kurs i ri bashkëkohor, i drejtuar nga MASH, krahas aplikimit të një strukture të re mësimore, krijon hapësira edhe për hapjen e degëve të reja, të cilat mund të ndryshojnë në varësi të tregut të punës dhe kërkesave të tij.

Nxënësit e kësaj shkolle, veçanërisht ata të profilit "Pyje" sëbashku me inxhinierët, kanë dhënë kontribut të çmuar në mbjelljen e fidanëve pyjorë dhe krijimin e masiveve të gjelbra. Ata kanë qenë në pararojë jo vetëm në muajin e pyjeve, por në të gjitha ndërmarrjet e mëdha në fushën e pyjeve. Në ngjizjen e tyre me profesionin e bukur të teknikut të pyjeve, ata janë shndërruar ndër ekologët e parë të zonave rurale, duke bërë një punë të lavdërueshme në sensibilizimin e komunitetit për problemet e mbrojtjes dhe kujdesit për sipërfaqet e gjelbra.

Sot shkolla ka në themel të saj rritjen e veprimtarive praktike në, e cila zë rreth 50 % të programit mësimor dhe realizohet në degën "Pyje" dhe "Përpunim Druri" në masën 100 %, falë

investimeve dhe fuqizimit të bazës materiale didaktike, me të cilën është pasuruar shkolla. Kjo ka bërë që të jetë e mirëpritur dhe e preferuar. Nxënësve u jepet mundësia që sipas programit mësimor të studiojnë e vizitojnë të gjitha zonat fitoklimatike të shtrirjes së bimësisë pyjore, florës dhe faunës, falë kushteve që ka krijuar shkolla. Po ashtu, nxënësit e profilit Përpunim Druri kanë mundësi të kryejnë praktikën në bazën prodhuese të shkollës, të pajisur me makineri nga më modernet dhe kanë mundësi të bëhen mjeshtër marangozë apo teknikë të përpunim drurit, duke mësuar të realizojnë të gjitha proceset praktikisht.

Të flasësh për këtë shkollë ka shumë për të thënë apo edhe për të hedhur në letër, por po ndalemi deri këtu, duke bërë edhe një apel për ata që duan të vazhdojnë shkollën teknike pyjore dhe nesër të jenë teknikë ose inxhinierë të ardhshëm: **"Afrohuni pranë saj: Është bukur të duash pyllin, por është edhe më bukur ta mbrosh e ta shtosh atë, sepse ke mbrojtur jetën tënde dhe të fëmijëve të tu!"**

Po ashtu, informojmë personelin që punon në fushën e pyjeve, që nuk ka shkollimin e duhur, se shkolla jonë mundëson studimin me kohë të shkurtuar, tre herë në javë, në të dy profilet, të Pyjeve dhe të Përpunim Drurit.

Për të mësuar më tepër për këtë Shkollë, mund të klikoni në faqen e web: www.kolemargjini.wordpress.com ose tel. 022 400 124

Deri në vitin 1944

Nga një studim i FKPKK në komunën Blerim edhe përpara pushtimit turk, malet shqiptare qenë gjithmonë të pavarur ose pothuaj të tilla nga Qeverisja e Shkodrës. Për banorët e këtyre maleve qeveria turke pothuaj nuk ekzistonte. Sipas dokumenteve, me vështrimin e parë duket sikur ligjet e saj nuk njiheshin nga malësorët, bilë as guvernatorët nuk shkaktajnë kurrfarë droje, siç thuhet. Ata kishin ligjet e tyre tradicionale e të respektuara edhe nga vetë qeveria, si dhe arrinin të qeveriseshin pothuaj vetë. Mendohet që nëse lindnin mosmarrëveshje, kryetarët e fiseve mblidheshin për të shqyrtuar rastin e caktuar. Studiues të ndryshëm argumentojnë se qeverisja turke malësorët i drejtoheshin vetëm kur për diçka ishin të ndarë midis tyre e nuk binin dakord, ose nuk donin t'i nënshtroheshin gjykimit të kryetarëve. Ndërsa, nëse një ligj hartohej si pasojë e një akordi të përbashkët të fisit, si dhe janë shënuar grantet e ekzekutimit, çdokush prej anëtarëve lypsej të bindej. Kësisoj, kur njëra palë i drejtohej gjykatës së qeverisë, kjo e

fundit nuk mund t'i përgjigjej ndryshe, veçse duke miratuar vendimin e fisit.

Nëse zyrtarisht dhe bazuar në dokumentet e shkruara pyjet e Blerimit, konsiderohen 100 % shtetërore apo të komunës, nga konsultimi me të gjitha familjet del se 69 % e sipërfaqes pyjore përdorej veçmas nga çdo familje dhe 31% e saj përdorej si pyll i përbashkët apo mera. Pra, pavarësisht ligjeve turke për regjimin juridik të tokës, paralel me të banorët kanë zbatuar rregullat e tyre. Mbetet enigmë fakti që e drejta e pronësisë mbi token, e pranuar nga autoritetet lokale, nuk u ligjërua në kohën e mbretit zog. Po ashtu, mbetet enigmë vendimmarrja e familjeve të fshatrave të Blerimit gjatë regjimit të kaluar, pasi në atë periudhë ka pasur shtim shumë të ndjeshëm të numrit të familjeve.

Në periudhën 1945-1996

Pas vitit 1944 pyjet e kullotat administroheshin nga shteti (Ndërmarrjet Pyjore) dhe përdorimi i tyre ka qenë kolektiv e për interesa të shtetit. Në planet e mëparshme të mbarështimit të pyjeve dhe në të

Për ecurinë e pronësisë së pyllit dhe merasë që nga koha e sundimit otoman

gjitha studimet e kryera, pylli në përgjithësi është trajtuar vetëm në funksionet prodhuese. Tek pylli shiheshin vetëm vlerat e përdorimit të drurit, të cilat duhet të viheshin në shërbim të ekonomisë së përbashkët. Vlerat ambientaliste, rekreative e të biodiversitetit anashkaloheshin apo kishin peshë të pakonsiderueshme. Të drejtat e fshatarëve ishin tepër të kufizuara. Termi pyll fshati, që filloi të përdorej nga mesi i viteve 1980, shihej më tepër si sipërfaqe e kufizuar në tokat e kooperativës. Në këto kushte, fshatarët filluan ta shohin pyllin si diçka të largët. Pa i pyetur fare, pylli i tyre një ditë të bukur pushtohej nga sëpatat e kazmat dhe shndërrohej në tokë të re. Pasi prodhonte një vit apo dy, braktisej dhe niste erozioni. Sot këto ish-pyje janë sipërfaqe inproduktive, që kërkojnë shumë investime për t'u rehabilituar.

Planifikimi pyjor ishte monopol i shtetit të centralizuar. Nëse në bujqësi mund të bëhej fjalë për një

planifikim me direktiva nga lart, po edhe duke marrë mendimin e fshatareve, për pyjet e kullotat vendimet merreshin nga ndërmarrjet e pyjeve, pa ndonjë konsultim paraprak me komunitetin. Plani i mbarështimit ishte dhe mbetet

akoma një term i panjohur apo jofamiljar për fshatarët, pasi ata nuk kishin marrë pjesë në këtë proces dhe as që ishin pyetur, ashtu sikurse pyeteshin fjala vjen kur bënin projektplanin e brigadës për bimët bujqësore.

Përdorimi aktual i pyjeve sipas fshatrave

Në tabelë jepen të dhëna për përdorimin e pyjeve dhe kullotave në komunën Blerim, duke i ndarë në pyje që përdoren nga familjet, si dhe pyje e kullota mera, që përdoren bashkërisht nga fshati. Ve-

ndimi për çdo rast është marrë pas konsultimit me këshillin e fshatit dhe me përdoruesit kufitarë lidhur me të drejtat dhe përdorimin e tyre, ku duket se vendimet janë marrë sipas traditave.

Fshati	Përdorimi i pyjeve (ha):			Përdorimi i kullotave (ha):		
	Familje	Fis	Fshat	Familje	Fis	Fshat
Dardhë	685.95	0	0	0	0	3.80
Qebik	220.50	0	0	0	0	0.00
Truni	0	0	1257.10	0	0	8.90
Sakat	562.10	0	0	0	0	0.00
Kulumri	363.95	0	0	0	0	0.00
Xath	309.45	0	0	0	0	0.00

Një studim bujqësor, hidroteknik në rajonin Gjakovë - Pejë - Istog

Prof.As. Dr. Ahmet OSJA

Në vitet 1941-1942, mes specialistëve të bujqësisë, blegtorisë e pyjeve, me origjinë nga Shkodra, që punuan në Kosovë, ishte edhe i mirënjohuri Dr. Nikolla Zadrina, bir i një familjeje me emër në Shkodër. Pasi ishte shkolluar në fakultetin e Agronomisë dhe kishte kryer disa specializime për sistemim - ujitjen e tokave bujqësore dhe rritjen e orizit, kthehet e punon me përkushtim e profesionalizëm në atdheun e tij. Ai zotëronte katër gjuhë të huaja.



Dr. Nikolla Zadrina

Gjatë periudhës që emërohet drejtor i zyrës së bujqësisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, Tiranë, ai merr përsipër të kryejë një studim mbi sistemimin dhe ujitjen e njërit nga rajonet e Kosovës.

Në atë kohë, mes specialistëve të bujqësisë që punonin në Kosovë, 12 ishin nga Shkodra, të gjithë të shkolluar në metropolet e Evropës. Të aftë, të përkushtuar, ata bënë emër në zonat ku punuan e drejtuan sektorin e bujqësisë.

Dr. Nikolla Zadrina, pasi shkeli gjithë Kosovën dhe u njoh me çfarë ishte bërë më parë në fushën e sistemimeve dhe ujitjes, organizoi e zbatoi punën për një studim të mirëfilltë e me nivel të lartë shkencor. Në këtë studim u përfshi një sipërfaqe prej 98.875 ha, nga të cilat zbatimi do të kryhej


fillimisht në 13.577 ha. Zona e Drinit të Bardhë do të përfshinte 5.681 ha, zona e burimit Vrela 1.271 ha dhe ajo e Istogut 6.625 ha.

Pasi kishte siguruar bazën materiale të domosdoshme, ai kishte përcaktuar pozicionin gjeografik, të dhënat gjeologjike, pedologjike, klimatike, burimet ujore, traditën, etj. Të gjitha këto i kishte hedhur në harta përkatëse e të veçanta.

Kështu, kishte përcaktuar mbjelljet, duke i ndarë ato në të vjeshtës e të pranverës dhe ato të dyta. Kishte përcaktuar sipërfaqen që do të mbillej me grurë, misër, fasule, patate, foragjere, dru frutorë, livadhe, etj. Kishte përcaktuar llojet e punimeve, plehërimet, qarkullimet bujqësore. Mbi këtë bazë, kishte llogaritur normat e ujitjeve, sezonin, shtrirjen, ngritjen e veprave ujitëse. Këto për çdo zonë e kulturë.

Studimi u sistemua në 20 kapituj, i shoqëruar me harta, diagrame, analiza, foto, deri dhe me literaturën e përdorur e një përmbledhje në italisht. Ky studim u vu në dispozicion të pushtetit vendor.

Studimi ngre lart vlerat agro - ekonomike të rajonit të marrë në shqyrtim. Këtu mbahen parasysh interesat e bujqve kosovarë, për t'u bërë të mundur përfitime sa më të larta. Studimi u botua i plotë në Buletinin tekniko-bujqësor nr. 1, 1943.



Jo vetëm për kurrështje

... rrënjët e një akacieje në Afrikën Jugperëndimore, kanë arritur të futen deri në 68 m thellësi të tokës.

... sipas mitologjisë, Dafne ishte e bija e lumit Peneo dhe e dashura e Apollit. Për të shpëtuar prej këtij (Apollit), i ati e ktheu atë në **Dafinë** (lari), pemë e bukur, me gjethe erëkëndshme, gjithmonë e gjelbër.

... Druri i mështekës përmban 49 % celulozë dhe rreth 28 % linjinë. Ka edhe vajra etirikë. Nga përpunimi kimik i këtij druri nxirret alkool metilik, kurse nga lëvorja prodhohen vajra lubrifikantë. Gjethet përmbajnë 0.8 % vitaminë C, prandaj, përveç përdorimit në mjekësi, janë ushqim vitaminoz për bagëtitë. Me sythat dhe gjethet e këtij druri, mjekët popullorë përgatitin lëngje kuruese kundër gastritit, ulçerës së stomakut, reumatizms, si ndalues të rrjedhjeve të gjakut, plagëve, zhbllkues të qeskës së urinës, etj.

Baobabët dhe Sekujat ...

... Rrojnë më shumë se të gjitha pemët (drurët) e tjera; ato në Afrikë kanë jetëgjatësi disa mijëra vjet. Në Kaliforni (SHBA), në një sekujë të rrëzuar nga era, u vërtetua shkencërisht se kishte vegjetuar 3025 vjet.

Druri më i trashë ...

... Është Sekuja. Në Kaliforni, është llogaritur që një Sekujë ka jetuar 6000 vjet. Ndër tërë drurët e botës, Sekujës nuk ia gjen shoqen për sa i përket trashësisë. Trungu i saj arrin disa herë një perimetër prej 46 m. Mbi rrafshin e një trungu (cungu) të tillë, dikur kanë ndërtuar një shtëpi të vogël për redaksinë e revistës "Lajme nga druri gjigand"; mbi një rrafsh tjetër trungu të Sekujës u vendos një piano, një orkestër me 4 vegla muzikore dhe mbeti vend edhe për 16 çifte vallëzuesish!

Bredhi ...

... është shumë i ndjeshëm ndaj sulfurit të karbonit; ai i ndjen shumë avujt e këtij gazi dhe, për këtë arsye, nuk zhvillohet në afërsitë e qendrave të mëdha industriale.

Mirësevini në Prizren

Lashtësi, kulturë, pyje e peizazhe të mrekullueshme

nga Faruk BOJAXHI - Inxhinier pyjesh, Prizren

Ky qytet i lashtë, mbi 2000 vjeçar, me tradita atdhetare e kulturore, shtrihet në Jug të Republikës së Kosovës, minimalisht 310 m mbi rrafshin e detit, në kufi me Shqipërinë dhe vazhdon deri në lartësinë 2120 m, në vendin e quajtur guri i 13, në malet e Koritnikut.

Territori ka shumëllojshmëri terrenesh, duke filluar nga toka bujqësore mjaft cilësore, kodrina, pyje po cilësore (duke mos harruar edhe drurët-relikte, jo vetëm në Kosovë por edhe në Ballkan) dhe sipërfaqe kullosore mjaft të pasura me bimësi e peizazhe të mrekullueshme malore.

Kjo zonë e Komunës së Prizrenit ka një biodiversitet të jashtëzakonshëm, ku flora dhe fauna i shtojnë vlerat e saj.

Veçori dalluese e kësaj zone është edhe ndryshueshmëria klimatike, vera e nxehtë dhe dimri plot me dëborë.



Qyteti i Prizrenit renditet ndër të parët për nga madhësia, me dendësi të konsiderueshme dhe me një dinamikë jete që shpesh është mjaft e lodhshme e stresuese për njerëzit. Prandaj ata nuk zgjedhin vetëm qytetin për t'u relaksuar, po shpesh (sidomos në fundjavë) periferitë e sidomos zonën e Vermicës dhe atë të Zhupës. Këto zona të Komunës së Prizrenit vitet e fundit janë bërë mjaft të frekuentueshme nga turistët nga Kosova, nga Shqipëria e më gjerë. Mbrëmjet e

verës janë zbukuruar e gjallëruar nga dhjetëra autobuza e vetura, që hyjnë e dalin në portën e madhe e të hapur për shqiptarët e të dy anëve, po edhe për miqtë ballkanas e ngado që vijnë.

Ajo që vërtet u jep arsye turistëve që të vizitojnë këto zona është sektori i hotelerisë, i cili vitet e fundit pothuaj ka kapur majat e zhvillimit. Restorantet e bukura të të gjitha stileve, klasike e moderne, u japin një arsye më shumë qytetareve për të frekuentuar këto zona.

Në stinën e Verës bukurinë e kësaj zone e madhështon edhe lumi Drin i Bardhë, i cili me shtratin e tij të gjerë, kryen rolin e një ilaçi qetësues. Gryka e Lumëbardhit (Bistricës), një simotër e Valbonës, që e nis rrugën nga majat e maleve të Sharrit dhe kalon nëpër luginën e shkëlqyer të Zhupës, është një zonë që shumica e qyteteve të Kosovës e kane lakmi; kanionet që ka krijuar natyra janë bukuri të pashtershme e mjaft interesante.

Parku Kombëtar "Malet e Sharrit", i cili shtrihet më së shumti në territorin e komunës së Prizrenit, është një arsye shtesë që Prizreni të jetë ndër qytetet më të frekuentuara nga turistët.

Prevallat, me pyjet e bukur të saj, zë vend mjaft të rëndësishëm në rangun e vendeve turistike të kësaj komune.

Kohët e fundit, si kudo në Kosovë, edhe në këtë zonë të Prizrenit, është krijuar një kulturë e turizmit malor, i cili ka filluar të përhapet me të madhe. Qytetarë të shumtë shfrytëzojnë terrenet malore për të kaluar fundjavat.

Turizmi dimëror është një tradite e kahershme e banorëve të Prizrenit; vendet e skijimit dhe teleferikët janë përplot me turistë gjatë kohës me dëborë.

Shumë është shkruar e mund të shkruhet për Prizrenin, po ne në këto pak radhë u ndalëm në vlerat turistike të tij, të cilat nga dita në ditë ia shtojnë vetë banorët e kësaj zone, e shkuara dhe traditat, perspektiva që e pret, në kuadrin e zhvillimit të gjithë Kosovës.

Këto dy shkrime, të botuara vite më parë, ribotohen me kërkesën e një grupi lexuesish nga Prizreni dhe të një studenti nga Istogu.



TRAJTIMI I VERRISHTEVE E SHELGJISHTEVE, ME INTERES PËR FERMERIN

nga ILMIGJANA

Në tre ujëmbledhësit e rrethit të Kukësit, Veleshicë, Bushtricë e të Lumës, verrishtet e shelgjishtet, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e plepshiteve, janë përhapur e zhvilluar mjaft. Në përgjithësi verriri dhe shelgjet bëjnë pjesë tek drurët e butë dhe energjinë kalorifike e kanë më të vogël se drurët të tjerë, si dushqet, ahu, etj. Shelgjet, në krahasim me verririn e zi (*Alnus glutinosa*) janë edhe më të butë, prandaj gjithmonë janë përdorur për thupra, për punime artistike, me e pa lëvore, si shporta apo thurje të tjera e shumë pak për ngrohje, vetëm aty ku nuk ka drurë të tjerë.



Verriri i zi në Novosej (Shishtavec)

Shelgjishtet dhe verrishtet rriten e zhvillohen në vende me lagështi, sidomos përgjatë përrrenjve e lumenjve, si në rrjedhjet e Bushtricës, Veleshicës dhe Lumës, përgjatë luginës së Drinit të Zi dhe në përrrenjtë që furnizojnë këta lumenj. Në zonën e Çajës, Shkinakut, Bushtricës, Vasijeve, Ploshteve dhe përgjatë lumit Luma (sipërfaqes ujëmbledhëse), si Novosej, Turaj, Topojan, Brekij, Kollovoz, Borje, Nimce, Zapod e Bele, ku lënda drusore ka qenë dhe është problem për ngrohje, banorët kanë përvojë të vyer për trajtimin dhe përdorimin e këtyre dy llojeve drurësh, e sidomos për verririn. Zakonisht i kanë përdorur për të mbrojtur vendet që rrëshqasin, por edhe për të stabilizuar përrrenjtë, kundër gërryerjeve e përmbytjeve, në ato vende që në gjuhen e popullit quhen "porene". Prandaj, po i trajtojmë shkurt këto lloje drurësh në aspektin social dhe në atë teknik.

Në aspektin social. Verrishtet e shelgjishtet, të formuara në mënyrë natyrale apo artificiale, në përgjithësi janë të vendosura nëpër luginë apo përrroska dhe janë

të ndara edhe me kufij midis fermerëve. Në disa fshatra janë të instaluara në vende apo pyje të të gjithë fshatit dhe trajtimi apo shfrytëzimi nga banorët ka qenë dhe është shumë i kontrolluar, me rregulla shumë strikte, për të vetmen arsye se lënda drusore është shumë e pakët dhe janë rregullat e vendimet e vendosura prej tyre që s'mund t'i shkelë askush. Përgjatë këtyre merave të fshatit gjenden porenet private, për të cilat duhet theksuar se grykat e përrrenjve apo lumenjve edhe mund të lëvizin por kufijtë mes tyre nuk mund të lëvizin. Prandaj janë vendosur këto rregulla që vetëm fshati, me anë të merasë, të mos kalojë

cakun apo kufirin nga poreni apo zabeli me kufi, gjithashtu edhe përdoruesi tradicional të mos shkojë nga meraja e krejt fshatit, sepse ajo është e të gjithëve dhe, si e tillë, të gjithë vendosin për çdo gjë që mund të behet me këtë pjesë.

Në disa fshatra ka pasur dhe ka akoma disa rregulla për këto dy lloje kulturash ose, thënë ndryshe, për këto dy lloje drurësh, pavarësisht se si e kanë prejardhjen (lastarore apo farore). Një sipërfaqe e konsiderueshme caktohet dhe është caktuar edhe pas viteve '90 në një vend po me verrinj e shelg, por rrallë edhe me plep të zi, sepse këto lloje shkojnë në këto zona, sepse në këto zona apo anë nuk ka lloje të tjera të zhvilluar, për arsye klimatike.

Me përjashtim shumë të rralla mund të presë ndonjë fshatar, që nuk ka krahë pune, por edhe kjo bëhet me pëlqimin e gjithë fshatit pa përjashtim.

Në aspektin teknik. Verrinjtë dhe shelgjet janë drurë të butë në krahasim me dushqet, vidhin, ahun, blirin, etj. Verriri i zi mund të shkojë 1-1.5 m diametër dhe

25 – 30 m lartësi, ka lëvore të lëmuar në fazat e hershme dhe më vonë bëhet me të thelluara. Trungun e ka të drejtë, me degë të vendosura në mënyrë të çrregullt. Degët kanë bisqe të shkurtër (herë-herë mesatarë), me gjethe vezake apo të çrregullta, me nervaturë të rregullt, me ngjyrë të gjelbër të errët, prej nga ka marrë edhe emrin i zi (i errët). Verriri i zi ka lule monoike, në trajtë boçesh në dy lloje lulesash mashkullore dhe femërore. Lulesat



Verrishte (Shkinak) Çaj

mashkullore çelin me herët, njëlloj si te mështekna apo lajthia. Farat e verririt janë të vogla, me ngjyrë të kafentë në të murrme, me fuqi mbirëse të mirë dhe të lehta për t'u shpërndarë, sidomos me anë të erës dhe të ujit, anës përrrenjve e lumenjve, ku edhe gjendet më shumë.

Në të kaluarën lëvorja e verririt të zi është përdorur në punimet artizanale për ngjyrosje, sidomos të shajakut të përgatitur nga leshi i deles rudë. Po ashtu, lënda e punimit të verririt të zi është përdorur dhe këshillohet të përdoret në miniera, për shtylla, sepse ka vetinë e "paralajmërimin" në raste shembjesh apo në thyerje druri lëshon kërcitje dhe për këtë arsye të përdoret. Druri i verririt mund të përdoret edhe në fabrikat e përpunimit dhe të regjies së lëkurëve apo edhe tjera të

kësaj natyre, sepse ka përmbajtje tanini dhe tape. Verriri i zi ka vetinë e lastarizimit të fuqishëm gjatë prerjes për dru zjarri, për hunj apo edhe për thupra. Është me rritje të shpejtë, si në lartësi edhe në diametër. Është tipik dritëdashës. Meqë në këto zona drurët e tjerë janë të pakët verriri i zi është përdorur kryesisht për dru zjarri, rrallë edhe për lëndë ndërtimi, për trarë të ndryshëm, por ato kanë jetëgjatësi më të vogël se dushqet dhe ahu.

Verriri i zi mund të pritët me prerje të quajtura rrah dhe mund të përftohet grumbull njëmoshor apo njëkatësh. Kjo mund të bëhet kur një poren apo grumbuj të vegjël verriri të zi nuk janë uniforme në strukturë dhe përbërje.

Mund të bëhen edhe prerje me të zgjedhur dhe struktura bëhet shumëmoshore apo më shumë se njëkatëshe. Kjo mënyrë është më e përhapur, sepse fermeri ka nevojë çdo vit për thupra, hunj e dru zjarri, por gjithmonë duke ruajtur numrin e drurëve/ha. Në këtë vështrim mund të këshillohet fermeri se si ta bëjë prerjen, në mënyrë që të trajtohet verriri dhe të ruhen pyjet apo grumbujt e dushqeve e të frashrit për lëndë punimi dhe verriri për dru zjarri.



Verrinj në Vilë – Bushtricë

Shelgjishtet

Edhe Shelgjishtet janë një burim i mirë, si për dru zjarri edhe për punime artistike. Shelgjet janë të ndryshëm e të shumëllojshëm, por më të përhapur e gjithmonë të përzier me verririn janë shelgu i bardhë (*Salix alba*) dhe shelgu i kuq (*Salix incana*).

Që të dy llojet gjenden në vende me lagështirë e të freskëta, në toka skeletike e ranishte, më vete dhe të shoqëruar me verririn e zi e rrallëherë edhe me plepin e zi (*Populus nigra*). Si verriri i zi edhe shelgjet gjenden nëpër porene, buzë arave e livadheve, por gjithmonë janë mbrojtur e menaxhuar nga fermeri për nevojat të ndryshme shtëpiake e bujqësore, sidomos për dru zjarri.

hime në pjesën e poshtme të pajisura me push dhe me ngjyrë si në të bardhë. Bisqet njëvjeçare janë të hollë dhe elastikë. Në përgjithësi shelgjet janë me rritje të shpejtë dhe dritëdashës, kanë aftësi të madhe lastarizuese. Lastarët e shelgut ose ndryshe thuprat përdoren gjerësisht për thurje të ndryshme: për kosha, shporta e kanistra, për punime artistike, në mobilieri e më gjerë.

Shelgjet janë përdorur edhe për dru zjarri, duke i prerë në breza. Druri i tyre i fortë është shumë i përdorshëm për këtë qëllim. Por gjatë trajtimit dhe pas stabilizimit të përrrenjve e lumenjve shelgjishtet përdoren shumë për kullotjen e gjedhit e njëthundrakëve.

Meqë shelgu është një e ardhur e mirë për familjet



Shelgjishte (Malqene) Ujmisht

Shelgu i kuq (*Salix incana*). Gjendet në të gjithë ujëmbledhësit e rrethit të Kukësit dhe, së bashku me verririn e zi, përbejnë një biotop të stabilizuar e të qëndrueshëm. Ky lloj klasifikohet herë si shkurre e herë-herë si dru pyjor. Lartësia e tij mund të shkojë deri 4 m dhe trashësia 25 cm. Ka trung të drejtë, në moshë të re me lëvore ngjyrë kafe në mavi, nga ka marrë edhe emrin. Gjethet janë në formë heshtake, të përkundur drejta, të gjelbra në të për-

në fshat, lypset mbrojtur nga zjarret apo nga dëmtime të tjera dhe duhet trajtuar sipas kriterëve e masave të silvikulturës natyralistike.

Në këto biotope zhvillohet mirë edhe një jetë e egër, që po merr një dimension tjetër nga ç'ishte më parë, kur ato trajtoheshin ndryshe ose nuk trajtoheshin fare. Më të përhapur janë: Lepuri i egër, dhelpa, ujku, në zonën e poshtme baldosa dhe mjaft shpendë, si në numër edhe në lloje.

Lajmërim

Disponojmë:

- Fidanë arre dyvjeçarë 5000 copë
- Fidanë gështenje dyvjeçarë 5000 copë

Të interesuarit të kontaktojnë me

068 20 77 157 dhe 068 34 01 378



GJON FIERZA
Inxh. në DSHP, Tiranë

Mali i Dajtit, "ballkoni" nga mund të vështrosh Tiranën

Pyjët janë burim jete. Pyjet janë të bukur. Pyjet të sjellin kënaqësi e emocione, të bëjnë të jesh më krijues ... Çdokush nga ne i do pyjet, pasi në perceptimin e njerëzve ata janë simbol i përvetshëm i natyrës.

Një ndër pasuritë pyjore më të vlefshme e më të rëndësishme kombëtare është edhe parku kombëtar "Mali i Dajtit". E shkuara dhe jeta e sotme e kryeqytetit shqiptar janë të lidhura ngushtë me të. Edhe këto ditë të nxehura të kësaj vere të rrallë, freskia dhe ajri i pastër e jetëdhënës, të thërrasin të jesh në gjirin e tyre, në Dajt. Kryeqyteti ynë, ndoshta e ka të barasvlerëshëm me truallin ku shtrihet edhe malin e Dajtit, që lartësohet në lindje të tij. Natyra ka bërë që Tiranës andej nga i vjen dielli t'i vijë edhe gjelbërimi i përvetshëm me malin e Dajtit. Siç thuhet për një qenie të bukur, që "Zoti e ka punuar më ngë", ashtu mund të themi edhe për malin e Dajtit. Aty, gjelbërimitin e ke si e do, të përhershëm ose jo, bimë e drurë të madhësive të ndryshme, lule në çdo stinë. Kafshë e shpendë të larmishëm ke në këtë mjedis pyjor ... Terrenin, si e do, të thepisur e shkëmbor, lëndina e livadhe të sheshta. Burime të kristalta e jetësojnë këtë mal nga rrëza deri në majë. Në malin e Dajtit ka dhe rrënoja të vendbanimeve të lashta, që presin për t'u eksploruar. Bimësia barishtore dhe pyjore,



në formë të shkallëzuar e vesh malin, duke filluar nga shkurret mesdhetare përherë të gjelbra dhe ahishtet e freskëta, që jeshilojnë fuqishëm në verë. Në tërësi parku kombëtar "Mali i Dajtit", përfaqëson një ndër vlerat më të mëdha të biodiversitetit shqiptar. Ky park vazhdon të jetë i pëlqyeshëm për ekskursione të shkollave jo vetëm nga Shqipëria po dhe Kosova, etj. Tashmë ky park është pjese e guidave turistike, jo vetëm për vizitorët vendas po edhe për ata të huaj. Ai ka filluar të shërbejë edhe si vend tubimesh për shoqata të ndryshme atdhetare e patriotike.

Teleferiku "Dajti Express", i vlerësuar si unikal në Ballkan, u mundëson vizitorëve mbërritjen e shpejtë e të këndshme në Dajt brenda 15 minutash. Udhëtimi me teleferik është "prelud" i kënaqësisë që ndjen gjatë vizitës në malin e Dajtit. Bashkatdhetarët tanë në botë, kur sjellin miq të tyre, ndoshta ndër ofertat

për të vizituar Shqipërinë, u servirin edhe udhëtimin me teleferik për në Dajt. Sapo mbërrin në stacionin e sipërm të teleferikut, çdo vizitor hedh vështrimin drejt pyllit e livadheve, drejt majës së malit, po kthehet edhe pas e, nga "ballkoni" natyror, vështron si në pëllëmbë të dorës kryeqytetin, Tiranën,



dhe hapësirat përreth saj, deri buzë detit, në Durrës. Nuk mund të gjendet ndonjë pikë tjetër nga ku mund të soditet më mirë Tirana dhe zonat që e qarkojnë. Tiranasi nga ky "ballkon" përpiqen të shquajnë vendbanimin e tyre, ndërsa vizitorët e largët institucionet e ndërtesat e ndryshme

interesante ... Disa "vështrime" se ku do të kalojë bulevardi i madh, drejt Paskuqanit, nesër drejt Farkës, etj. Kënaqësia e është madhe për çdo vizitor, edhe duke kaluar drejt pyllit, nëpër lëndinat me bar. Vizitori ka etje dhe mundohet të shijojë e prekë gjithçka nga mjedisi pyjor, të dëgjojë cicërimat e zogjve, të ndiejë aromën e luleve ... Por, ... ecën diku me tej, në rrugët auto, që përshkojnë parkun dhe, për fatkeq, nuk ndjehesh mirë, kur sheh ngrehina aspak komode, që e shëmtojnë parkun, kur sheh një "pyll antenash metalike" ... Dhe, secili do që ta harrojë atë pamje!?

Gjithçka është bërë deri tani nga Shërbimi Pyjor, që mjedisi pyjor të mos dëmtohet; pra drurët

nuk janë prerë ose djegur. Në thellësi të pyllit gjen një mjedis thujse akoma të virgjër, gjë që s'mund të thuhet për sipërfaqet anës rrugëve, ku janë ndërtuar lokale shërbimi apo dhe gurore, disa prej të cilave punojnë akoma!? Personeli pyjor kontrollon hyrjet dhe lëvizjet në park, përpiqet të administrojë e

• "Mali i Dajtit" është shpallur park kombëtar në vitin 1960, me sipërfaqe 2100 ha.

• Në vitin 1966, u zgjerua dhe zuri një sipërfaqe prej 3300 ha.

• Në vitin 2006, u zgjerua deri në rreth 29400 ha.



mbajë pastër sipërfaqet e përdorshme nga vizitorët, por kjo nuk mjafton. Si kudo në botë, lypset që kushtojë që hyn në park të jetë i përgjegjshëm për të mos e dëmtuar atë. Pra, secili ta trajtojë si pronë të tij. Pas kënaqësisë që mori nga ky udhëtim në Dajt, secili le të shohë pak pas, në lëndinën apo vendin ku pushoi, nëse atë mjedis ai e la të pastër, për pasardhësin e tij.

Jemi në kohën kur për kryeqytetin tonë, Tiranën, po ndërmerren projekte madhështore të zhvillimit perspektiv afatgjatë. E, me këtë rast, nuk mendoj se ka vlera më të pakta një plan rregullues sidomos për pjesën qendrore të parkut, atë që duket nga Tirana, qoftë ky i krahasuar edhe me një bulevard të Tiranës. Parku kombëtar "Mali i Dajtit" është pjesë e Tiranës. Ai i shër-

ben jetës së banorëve të saj dhe, si i tillë lypset vlerësuar. Ai duhet konsideruar si kurorë e gjelbër, që ndikon fuqishëm në përmirësim të kushteve jetësore, jo vetëm të atyre që jetojnë pranë apo në brendësi të tij, po në tërësi për Tiranën.

Për njohuri, shtojmë se përveç pjesës së dukshme nga Tirana, parku sot është zgjeruar shumë në sipërfaqe. Ai shtrihet edhe në zonat pas malit të Dajtit, në basenin e Bovillës, në disa sipërfaqe të rrethit të Krutës, në Malin me Gropa, në hapësirat deri në lumin Erzen. Me këtë sipërfaqe, "Mali i Dajtit" është parku kombëtar më i madh në Shqipëri. Në brendësi të këtij parku ka disa fshatra me një numër të madh banorësh, që kanë lidhur jetën dhe ushtrojnë vepërimtari në mjediset e tij.

"T'i tregojnë babait arat"

Gjenerata e sotme nuk është as e para dhe as e fundit përdoruese e tokës dhe mjedisit. Me qindra gjenerata, që jetuan para nesh, provuan, mësuan e na dhuruan jetën, tokën e mjedisin. Çuditërisht, dy shekujt e fundit njeriu sikur u deh nga industrializimi. Apo ëndrra e urbanizimit. Njerë-

zit e zonave urbane e harruan origjinën, duket se u dashuruan me mekanizimin dhe prodhimin e lartë, shpesh artificial, e mbyten fshatin me lëndët larëse e lavatriçet, që kanë helmuar pothuaj gjithë ujërat e globit, duke zhdukur që nga peshqit e çdo gjë të gjallë tjetër. Përgjithësisht gjykimi i tyre karshi

traditës së banoreve ruralë ishte skeptik dhe, duke shfrytëzuar qeveritë e mediet, shpesh edhe shkollat, që shtrihen në territorin e tyre, filluan "t'i tregojnë babait arat", apo të mësojnë kultivuesit e vreshtit "si bëhet vera apo rakia", duke prodhuar shpesh ligje apo sisteme prodhuese, që pengojnë banorët ruralë të sillen me natyrën si të parët e tyre e duke im-

ponuar shpesh nonsense.

Mësimi që vjen nga lashtësia është që ne mund të punojmë me natyrën e të vjelim prej saj atë që ajo na ofron, në atë mënyrë, që t'i shkaktojmë sa më pak shqetësime dhe t'i mbajmë pyjet të bukur e prodhues, si për njeriun, edhe për llojet e tjera që banojnë në globin apo shtëpinë tonë të përbashkët ...

H. K.

Gjethja më e madhe në botë ...

... Gjendet në drurin shumë të bukur, që quhet "Victoria regia" dhe vegjeton në brigjet e Amazonave (Amerika e Jugut), në pyjet e pakalueshme tropikale, ku ajri është i ngrohtë e me lagështi, si në një banjë avulli. Gjethet lundruese të viktorias, në sajë të cepave të tyre, të përthyer, duken si tiganë të mëdhenj; gjatësia e tyre arrin mëse 2 m. Mbi një gjethë të tillë mund të qëndrojë mbi ujë, një fëmijë 2-3 vjeç sikur të ishte mbi një varkë. Pjesa e sipërme e gjethes është e lëmuar dhe ka ngjyrë të gjelbër të çelur, ndërsa ajo e poshtme ka ngjyrë të kuqe të errët, me një rrjetë damarësh të trashë dhe kreshtash të gjata. "Victoria regia" ka kohë që kultivohet edhe në serrat evropiane.

"THE FORESTS ARE TRANSFERRED WITHOUT A LAW ... WHO MANAGES THEM?"

From Rexhep NDREU



Private ownership on the agricultural land, fruit trees, olive groves, forests, pastures and meadows has been recognized since in early 1900s years. Common property of the village and tribe has existed also. There were strict laws and mores for the preservation of property, which have been implemented from society of that time as an unwritten law.

In particular "Canon of the Mountains" and "The law of forest and pastures" of the year 1923, contained harsh punishment for property laws breaking.

During the transition period, the main objective of Forest Policy, in terms of development of private

forestry has been the retrieval of private forests according to the ownership of year 1945.

Ownership recognition and the retrieval of taken properties during years 1945 -1990 it is defined even on the Republic of Albania Constitution enacted in 21 October 1998 (sections 41 and 181).

Section 181 defines the objective of the Parliament to amend and fill in within 2 – 3 years the legal framework regarding to land usurpation or confiscation, made before enacting of the Constitution. General Directorate of Forest and Pastures' strategies for Developing of Forest and Pastures sector in Albania (1999 – 2004) admitted "the recognition of private ownership and public property privatization rights" (page 45).

Mentioned this short historical description to conclude that does exist the possibility for public property privatization according to the Constitution.

According to data published by **Pilot Communes in Malzi, Bujan (Kukes District), Melan, Maqellare, Zerqan, Ulez (Diber District), Blerim (Puke), Kurvelesh (Tepelene), Markat (Sarande), Grekan, Tregan, Paper (Elbasan District) results that over 30% of inhabitants** are recognized as traditional owners of forest and pastures and the village people recognize and confirm them as such.

This is emphasized even in many Management Plans of first Project of the World Bank for more than 130 communes, APFDP and NRDP (Natural Resources Development Project) plans, in 240 Management Plans.

This is a good basis on arguing to the Government that based on the tradition and Constitution of Albania, privatization is possible and on this basis, in the New Forest Law that we are making, it is necessary to be set the private ownership and recognition by law of traditional owners that village people recognize.

In 10 years neither a fire at the farmers' forests that the Ministry doesn't recognize! At the farmers' forests that users are traditionally recognized only, in the last 10 years there is neither a fire, damages, clearcuttings nor erosion.

In a time period of more than 10 years, over 200 thousands hectares of oak forests totally degraded in the regions of Librazhd, Drini Valley, Shkoder, Malsi e Madhe, Kukes, Has, Tropoje, Mati Valley, Burrel, Bulqize etc. as a result of carelessness by traditional owners and supported by Forest Associations and Federates, forests have reached to provide an annual growth 2 – 3 times greater than state or collective forests.

And this is documented with about 200 permanent test areas, which are monitored once a biennially and this is a lesson for the farmer and the foresters in terrain (**I invite everyone to see the evidences on the ground**).

Neither forest experts nor the leaders and the institutions have never recognized the **grove system**, to which is been working almost from the major part of farmers in small forests around houses, which are a great potential that make possible providing of fuelwood, foliage for livestock, kindling etc. and help in the protection of high beech and pine forests in mountainous areas.

For us this is that 30% we are talking about the privatization that rescues not only high forests but also integrates the farm and legalizes the users, provides a better usage and increases people's responsibility for the land and forest and improves their living.

The Directorate of Forest and Pastures and the Faculty of Forestry Sciences need to get down on the ground and learn the reality, for themselves but even to teach this age-long reality to experts and students on the manners of Forest Management by the farmers in Albania.

Must be emphasized also that the rural population comprises about 43% of total population and 71% of rural population is employed at agricultural activities, including forests.

According to us, the transfer process must be continue on the basis of the Law 1. 8743 date 22.02.2001 and the inventory of properties should be sent to each Local Government Unit (LGU) accompanied with the relevant documentation as the forest cadastre with the existing situation and the forest and pastures map (digitalized and vectorial).

The Ministry should make the registration of all properties, forest and pastures in the Immovable Property Registration Offices, by analyzing the needs and possibilities and to be done the transfer of forest and pastures according definitions made by Ministers Council, with a decision for each Local Government Unit.

So, on the basis of this law, when the transfer of properties is to be done, it is needed to be accompanied even with the financial obligations of local and central government for maintaining and improving of property, which is not done so far although it is been requested from LGUs.

FORESTS CANNOT BE PRIVATIZED WITHOUT A LAW!

Based on the existing laws and Government decisions, public properties cannot be privatized, therefore the requirement of the Government is **to be found privatization mechanisms** and we think that the better mechanism is that traditional owners need to be legally recognized as the village's people recognize them.

In the New Law that decisionmakers are trying to make, needs to be attached this requirement of the Government **and traditional users in Albania**, with the aim to bring up a new guarantee for a sustainability of forest management for the first time in Albania, but even by correcting historical injustices made unto owners that in fact have been and are numerous. (**In the same way as the village's commission has decided about agricultural land sharing, it must decide even for forest land sharing according to the traditional users recognized by them**).



Press release

August 14th 2012

Balkan Lynx presence proved in Shebenik-Jabllanica National Park

The Association for Protection and Preservation of Natural Environment in Albania (PPNEA) is pleased to inform you that on August 7th, 2012, the first Balkan Lynx picture was taken in the area of Shebenik-Jabllanica National Park. This picture is the culmination of several years of wildlife monitoring undertaken from PPNEA within the national park territory. According to the field researchers Aleksandër Trajçe and Bledi Hoxha two intensive monitoring sessions have been carried out during 2009 and 2011 in the area, but they both failed to prove the presence of the Balkan lynx there. On the other hand, in 2012 a sporadic monitoring session was conducted, which even though limited in time and space, resulted to be successful. Shebenik was proclaimed a protected area precisely because of its regional values as an important habitat for large carnivores and especially because it was assumed that Balkan lynx might be present as well. Therefore, the first proof of the Balkan lynx existence inside the boundaries of the park gives us hope that in the future this species will be more protected, and widely known as the symbol of the natural heritage of the area.



PPNEA invites all the stakeholders of the National Park to cooperate and coordinate in management and conservation actions, so that we can be optimistic that the Balkan lynx will continue to wander free in the Albanian forests, and will remain a source of inspiration and pride for the next generations as well.

May you have further inquiries, please feel free to contact PPNEA in the address below: Rr. "Vangjush Furxhi", P. 16/1/10

Tiranë, Shqipëri
Email: contact@ppnea.org

Page 2

How beautiful if it happened this way

The environment itself dictated that the first pelagian was conceived in the interior of a bird as the Eagle was. The goat that lived near the peaks where the eagle had the nests, undertook to grow him up. Then later the education was necessary and this was undertaken by the Oak. Here in the Dodona of Epirus, the nature took care about this kind of tree with a special appearance. Here in the Holy Dodona, under the crown of this tree, the pelagian putting both hands in the ground began to pray but what was special was that here he also received the explanation of the unknown and the mysteries of the future. Here the service was done by the Oracle for which the natives had many honors. This continued generation to generation until the hero of Albanians Gjergj Kastrioti – Skenderbeu undertook the destinies of his country, although he moved to Kruje he took the symbols from antiquity, so he put the eagle in the flag as was believed that the predecessors had the origine. He put the head of the goat in the helmet and the leaves of the oak in the pelerine and called himself: King of Epirus.



Page 3

Ahmet OSJA

There are just a few people, out those who are in a total conflict of interest that have objections on the privatization process, comparatively to the major part of people and structures of all levels.

Let's hope that together with the accumulated experience to support the sector for a deep reform toward transfer, privatization and registration of private forests. We think this is the most efficient alternative to ensure the protection and a sustainable management of forest and pastures as a major objective in the conditions of climate changes in Albania and beyond.

Should forests be given on concession in Albania?

Based on the current observations context, Albania is facing to apparent loss of forest capital. Data from multiple sources, continuously transmit the same message. From analysis made we should believe that Albanian forest at the current situation has no capacity to meet the needs of rural areas for fuelwood and industrial timber and south pastures do not meet livestock needs for grazing. These alarming indicators are given not only by researches in management plans but people talk about them every day. As it is declared, about 50% of forests or forest fund already is transferred to 317 LGUs' ownership and this process is continuing under a special order of the Minister of Environment 1 4086 Prot. date 13.07.2011 **and Government's objectives for the transfer and privatization.**

We think that:

- Are the Communes/Districts and traditional users that must decide of how they will utilize their forests through associations / utilization companies and not to be decided from the top by Directorate of Forest and Pastures or Directories of Forest Service that forest to be utilized on concession, where forests are in communes' ownership and the expectation of the Government is to deepen further more the privatization;
- The objective of Government and the Ministry of Environment is to be increased the area and the number of the protected areas;
- Apart to categories of Protected Areas according to the classification of IUNCN, Ministry of Environment has proclaimed by Ministers Council Decision (MCD) even a part of forests as strategic reserves, that can be used only in cases of natural disasters.

The above arguments as well as the real situation of forests in Albania make it impossible the idea of developing the concession in forests.

Furthermore, international experts (the mission of World Bank) adds that based on the experiences of former Republics of Soviet Union, results that the concession is not a good form neither for these countries that are rich on forest sources.

Page 1, 2

KURORA E GJELBËR

Gazetë e FKPKK, Shqipëri dhe e APPK, Kosovë

Këshilli Botues: A. Proko, N. Çollaku, V. Tabaku, J. Male, B. Gashi, I. Zeka, B. Hoxha
Kryeredaktor: AHMET OSJA **Zv.kryeredaktorë:** Nijazi IDRIZI, Ferdin LIÇAJ, Albora KACANI
Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, M. Shehi. **Redaktor përgjegjës:** V. Hoxha
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e ZP, kati II, Tiranë
Mobile: 068 40 75 975; **e-mail:** fkpkk@hotmail.com; velihoxha@yahoo.com

www.fkpkk.org
www.akppp.org

